

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6399
E shtunë, 28 gusht 2021
çmimi 0.40 €

KQZ-ja nuk e certifikon
kandidaturën e Selim
Pacollit për kryetar të
Prishtinës | FQA 7



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA SHUMË SHPEJT PRITET TË VENDOSË PËR MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT | FQA 4-5

SHTYHET VITI SHKOLLOR, SHKURTOHET ORARI I GASTRONOMISË, KTHEHET ORA POLICORE



Me qëllim të uljes së rasteve të të vdekurve dhe të të infektuarve, Qeveria e Kosovës shumë shpejt do të vendosë për miratimin e masave të reja kundër Covidit. Masat kufizuese që do të jenë në fuqi deri më 13 shtator, përfshijnë: shtyrjen e fillimit të vitit shkollor, shkurtimin e orarit të gastronomisë deri në orën 21:30 dhe vetëm në ambiente të jashtme, si dhe do të ketë kufizim të lëvizjes nga ora 22:00 deri në orën 5:00

Rreth 7 500
fëmijë të
vaksinuar | FQA 3



Dialogu Kosovë - Serbi
vazhdon më 7 dhe 8 shtator | FQA 5

AKTUALE

KOMANDANTI I KFOR-it
VLERËSON SITUATËN
E SIGURISË NË KOSOVË | F. 5

SITUATA ME COVID, RAMOSAJ: TË
GJITHË MJEKËT E PENSIONUAR TË
KTHEHEN NË PUNË | F. 6

TË HËNËN FSK-ja PRANON
AUTOMJETET E BLINDUARA,
DONACION NGA SHBA-ja | F. 3



EKONOMI

37 PËR QIND E RRUGËVE
NUK KANË KONTRATA
PËR SINJALISTIKË | F. 8

AFARISTI SHKËLQIM DEVOLLI
TAKON PRESIDENTIN TURK
ERDOGAN, BISEDONJË PËR
EKONOMINË | F. 8



SPORT



PRISHTINA DHE BALLKANI
KËRKOJNË MAKSIMUMIN NË
DERBI | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mali i Zi kap mbi një tonelatë drogë

PODGORICË, 27 GUSHT - Policia e Malit të Zi ka njoftuar të premten se ka konfiskuar mbi një tonelatë kokainë, sasinë më të madhe të drogës të zënë ndonjëherë në këtë shtet. Droga ishte fshehur në një dërgesë me banane. Policia, po ashtu, ka njoftuar

se ka arrestuar dy persona. Bastisja u krye në Mojanoviçi, një lagje në periferi të kryeqytetit Podgorica. "Ne po bëjmë atë që kemi premtuar: Mali i Zi nuk do të jetë vend i krimit", ka shkruar në "Twitter" zëvendëskryeministri i këtij

vendi, Dritan Abazoviçi. Mali i Zi është vend anëtar i NATO-s dhe ka hapur, po ashtu, negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Por, përpara se t'i bashkohet BE-së, ai ka për detyrë të çrrënjosë krimin e organizuar dhe korrupsionin.



Afganistanin e kërcënon edhe kriza shëndetësore

KABUL, 27 GUSHT - Furnizimet me ilaçe dhe pajisje shëndetësore në Afganistan janë duke u shpenzuar me shpejtësi, ka thënë Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH).

Institucionet shëndetësore së shpejti mund të përballen edhe me mungesë të personelit mjekësor, tha OBSH. "Na kanë mbetur vetëm pak ditë furnizime dhe po shqyrtojmë të gjitha mundësitë për të sjellë më shumë ilaçe në vend", tha Rick Brennan, drejtori i urgjencave të OBSH-së për rajonin e Mesdheut Lindor.

Dy sulme vetëvrasëse me bombë ndodhën më 26 gusht në afërsi të aeroportit të Kabulit duke lënë të vrarë shumë njerëz, përfshirë 13 trupa amerikane dhe duke shtuar vështirësitë e transportit të pajisjeve mjekësore dhe ilaçeve. Përgjegjësia e sulmeve e mori grupi ekstremist Shteti Islamik (IS).



Brennan tha se furnizimet përmes aeroportit të Kabulit nuk janë më një opsion për shkak të

situatës së sigurisë.

OBSH-ja kishte planifikuar t'i bëjë furnizimet përmes

transportit ajror, mirëpo ato janë anuluar pas marrjes nën kontroll të Kabulit nga ana e talebanëve

më 15 gusht.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka thënë më herët se tani po shikon mundësitë e pranimit të dërgesave mjekësore përmes një aeroporti tjetër Mazar-i-Sharif, që gjendet në veri të Afganistanit.

Sa i takon mungesës së stafit mjekësor, zyrtari i OBSH-së tha se shumë prej tyre po ikin nga vendi, ndërsa një numër i grave që punojnë në këtë sektor nuk po paraqiten në punë, mbase nga frika prej talebanëve. Shumë afganë kanë frikë nga hakmarrja e talebanëve pasi kanë bashkëpunuar me forcat e huaja gjatë 20 vjetëve të pranisë së tyre në këtë vend.

Ekzistojnë shqetësime të veçanta për gratë, të cilat u ndaluan kryesisht nga arsimi dhe punësimi dhe mund të dilnin nga shtëpia vetëm me praninë e një burri gjatë sundimit të talebanëve ndërmjet viteve 1996-2001.

Bullgaria forcon kufirin për migrantët afganë

BUDAPEST, 27 GUSHT - Bullgaria ka njoftuar se do ta forcojë kufirin e saj me Greqinë dhe Turqinë për shkak të shqetësimeve në rritje në Evropë për një fluks migrantësh nga Afganistani.

Marrja e kontrollit të Afganistanit nga talebanët ngjalli frikën për një përsëritje të krizës së migrantëve në Evropë, si ajo e vitit 2015, kur më shumë se 1 milion njerëz që iknin nga lufta dhe varfëria në Lindjen e Mesme arritën në bllok.

Shumë prej tyre kaluan nga Turqia dhe morën të

ashtuquajturën rrugë ballkanike për të hyrë në vendet më të pasura të BE-së. "Presioni mbi kufirin bullgar po rritet, gjë që kërkon nga qeveria të veprojë", tha ministri i Mbrojtjes i Bullgarisë, Georgi Panayotov. Bullgaria do të shpërndajë në kufi 400 deri në 700 ushtarë. Panayotov tha se ata do të jenë në dispozicion për ta ndihmuar policinë dhe xhandarët me "ndërtimin e barrierave dhe me vëzhgim".

Për çështjen e migrantëve afganë, presidenca slovene e Bashkimit Evropian njoftoi se

një takim urgjent i ministrave të Brendshëm të bllokut do të mbahet në Bruksel më 31 gusht. Turqia, e cila nuk është anëtare e BE-së, është gjithashtu e shqetësuar për një valë të re migrimi në Evropë dhe ka filluar t'i koordinojë përgjigjet. Turqia strehon gati 4 milionë refugjatë sirianë dhe 300 000 afganë, përveç migrantëve dhe refugjatëve nga pjesë të tjera të botës. Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë më 19 gusht se Turqia nuk e ka përgjegjësi të jetë "depo e refugjatëve në Evropë".



Shqipëria pret afganët e parë

TIRANË, 27 GUSHT - Në Shqipëri ka mbërritur grupi i parë i afganëve që kanë ikur nga

vendi i tyre, pas kthimit të talebanëve në pushtet në Afganistan. Një avion civil i një

kompanie egjiptiane i ka sjellë 121 persona në aeroportin e Tiranës në orët e hershme të së

premtës. Ata do të vendosen nëpër hotele në qytetin e Durrësit.



Rreth 7 500 fëmijë të vaksinuar

PRISHTINË, 27 GUSHT - Trembëdhjetë fëmijë të moshave nga tre muaj deri në 16 vjeç janë duke u trajtuar nga sëmundja Covid-19 në Klinikën e Pediatriisë në Prishtinë, thotë ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së kësaj klinike, Violeta Grajqevci. Në mesin e tyre në këtë qendër janë duke u trajtuar edhe tri foshnja të moshës nën tremuajshe. Grajqevci tregon se vetëm gjatë 24 orëve të fundit 17 fëmijë janë paraqitur për t'u kontrolluar në Klinikën e Pediatriisë, kurse tri raste kanë qenë për hospitalizim. "Vetëm gjatë muajit gusht në Klinikën e Pediatriisë janë trajtuar 36 fëmijë, kurse për gjashtë muajt e parë të këtij viti (janar-qershor) në këtë klinikë kanë qenë 67 fëmijë", tha Grajqevci. Ajo tha se që nga paraqitja e rasteve të para me Covid-19 në muajin mars të vitit të kaluar, dy fëmijë kanë humbur betejën me këtë

sëmundje. Javën e fundit Kosova po regjistron rritje të rasteve me koronavirus, teksa varianti "Delta", që është varianti më ngjitës, është bërë variant dominues i koronavirusit. Ministria e Shëndetësisë po raporton se ky variant po prek edhe fëmijët dhe adoleshentët. Vetëm në dy ditët e fundit (24-25 gusht) 547 persona të grupmoshave 0-19 vjeç, janë infektuar me koronavirus. Nga kjo shifër, 97 persona janë të grupmoshës nga 0-9 vjeç, kurse 450 persona të moshës 10-19 vjeç. Simptomat më të shpeshta të fëmijëve të infektuar, sipas daktoreshës Grajqevci, janë problemet me mushkëri, vjellje, diarre dhe temperaturë. Ajo kërkon kujdes nga prindërit, që fëmijët t'i zbatojnë masat mbrojtëse kundër koronavirusit, respektimin e distancës,

higjienës dhe veshjen e maskës. Njëherësh kërkon vaksinimin e personave nën moshën 18 vjeç, sidomos tashmë në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. "Pasi varianti 'Delta' ka një përhapje më të shpejtë krahasuar me format e tjera të virusit, do të ishte shumë e mirëseardhur të bëhet vaksinimi i moshave pediatrike aty ku lejohet. Vaksinimi te grupmosha 12-16 vjeç, tek ata fëmijë me imunitet të komplementuar, kurse të rinjtë mbi 16 vjeç të fillojë vaksinimi në mënyrë sa më të madhe", thekson ajo. Nga mesi i këtij muaji (16 gusht) Qeveria e Kosovës ka lejuar imunizimin kundër sëmundjes Covid-19 edhe për personat nën 18 vjeç. Vaksinimi i personave mbi 16 vjeç me vaksinën 'Pfizer', ndërsa për grupmoshën 12-15 vjeç vaksinimi "do të bëhet me prioritet dhe sipas indikacioneve

shëndetësore". Deri më tani për personat nga 16 deri 18 vjeç janë vaksinuar 7 458 persona, ku disa nga ta kanë marrë të dyja dozat e vaksinës. Përhapja e shpejtë e variantit "Delta" edhe te fëmijët dhe adoleshentët ka bërë që edhe infektologët të bëjnë thirrje për respektim të masave mbrojtëse kundër koronavirusit, sidomos me fillimin e vitit të ri shkollor. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit më herët ka paralajmëruar se më 1 shtator do të nisë viti i ri shkollor me prani fizike të nxënësve në shkolla, kurse gjatë ditës së sotme është thënë se po shqyrtohet mundësia e shtyrjes së fillimit të vitit të ri shkollor deri më 13 shtator, por që nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar. Infektologu Sali Ahmeti, në një bisedë për "Radion Evropa e

Lirë", tha se fillimi i vitit të ri shkollor me prani fizike në shkollë mund të bartë rrezikshmëri për përhapje më të madhe të numrit të të infektuarve te fëmijët. "Sidomos në situatën e tanishme, kur kemi të bëjmë me virusin 'Delta', që është shumë më i transmetueshëm sesa variantet paraprake dhe kur nuk janë të kursyera as moshat e reja", tha Ahmeti. Përveç respektimit të masave mbrojtëse nga nxënësit, infektologu tjetër Xhevat Demiri shprehet se është e domosdoshme që përgjegjësit e shkollave të furnizohen me mjete dezinfektuese dhe të mbahet pastërtia në shkolla. "Tualetet të jenë në nivelin më të lartë të pastërtisë. Kuvendet komunale duhet të bëjnë përgatitje të jashtëzakonshme për kthimin e nxënësve në shkollë", thekson Demiri.




Të hënën FSK-ja pranon automjetet e blinduara, donacion nga ShBA-ja

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së ka njoftuar se të hënën do të organizojnë ceremoninë e pranimit-dorëzimit të donacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me automjete ushtarake të blinduara, të tipit M1117 ASV (Armored Security Vehicle). Kjo ceremoni do të

mbahet në Kazermën "Adem Jashari", me fillim nga ora 11:00. Për të përcjellë këtë ceremoni pjesëmarrës do të jenë presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Gjithashtu, në këtë ceremoni do të marrin pjesë edhe autoritete të larta ushtarake civile vendore dhe

ndërkombëtare. Ministri Mehaj ka bërë me dije se automjetet e blinduara taktike, të kompletuara me platformën e integruar të armatimit dhe pajisjet e nevojshme për përmbushjen e misionit, do të jenë sistem shumë i rëndësishëm i kapaciteteve ushtarake të FSK-së.





QEVERIA SHUMË SHPEJT PRITET TË VENDOSË PËR MASAT E REJA KUNDËR COVIDIT

Shtyhet viti shkollor, shkurtohet orari i gastronomisë, kthehet ora policore

Me qëllim të uljes së rasteve të vdekjeve dhe të infektiveve të reja, Qeveria e Kosovës shumë shpejt do të vendosë për miratimin e masave të reja kundër Covidit. Masat kufizuese që do të jenë në fuqi deri më 13 shtator, përfshirë shtyrjen e fillimit të vitit shkollor, shkurtrimin e orarit të gastronomisë deri në orën 21:30 dhe vetëm në ambiente të jashtme si dhe do të ketë kufizim të lëvizjes nga ora 22:00 deri në orën 5:00

EPOKA E RE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Rritja e numrit të vdekjeve dhe të rasteve të reja të infektiveve me Covid-19 ka shtyrë qeverinë të mendojë për masat e reja kundër Covidit. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, të premten ka njoftuar kryetarët e komunave me masat e reja që pritet të merren shumë shpejt nga Qeveria e Kosovës. Gjatë një takimi virtual me Asociacionin e Komunave të Kosovës, ai ka thënë se qëllimi i masave është ulja e rasteve të vdekjeve, infektiveve të reja dhe ndërprerjes së shpërndarjes së virusit. Në fjalën hyrëse ai ka deklaruar se versioni "Delta" i Covid-19 është duke u përhapur 4 deri 6 herë më shpejt. Ai ka bërë me dije se për shkak të situatës së rëndë do të shtyhet fillimi i vitit shkollor, do të kthehet ora policore dhe do të shkurtohet orari i pandemisë. "Mësimi nuk fillon deri më 13 shtator dhe atëherë të rivlerësohet situata. Gastronomia do të punojë vetëm

deri në orën 21:30 dhe vetëm në ambiente të jashtme. Do të ketë kufizim të lëvizjes nga ora 22:00 deri orën 5:00. Do të rekrutohen 1 116 personel shëndetësor dhe inspektues për ta fuqizuar betejën kundër kësaj pandemie. Komunitat në shkallë 92 për qind, sipas kërkesave të tyre, janë furnizuar me barna esenciale. Në fillim të shtatorit do të mbërrijnë edhe 470 mijë vaksina përmes 'Covax'. Deri më 13 shtator do të punohet vetëm me staf esencial nëpër institucione", është thënë në njoftimin e AKK-së. Në anën tjetër, edhe kryetarët e komunave ia kanë paraqitur ministrin Vitia disa kërkesa. "Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkoi nga Ministria e Shëndetësisë që të shtohet numri i qendrave të vaksinimit, të shtohet numri i inspektorëve komunalë për respektimin e masave kundër Covidit si dhe rekrutimi i stafit shëndetësor të decentralizohet te komunat. Ministri i Shëndetësisë, z. Vitia, lidhur me kërkesën për shtimin e qendrave të vaksinimit, tha se

numri i të vaksinuarve bëhet në proporcion me numrin e vaksinave që shteti ynë ka në dispozicion", është thënë në njoftimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Oda Ekonomike kundër masave të reja kundër Covidit

Pas paralajmërimit të masave të reja, ka reaguar kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, i cili është kundër masave të tilla. Rukiqi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se ora policore dhe kufizimet në orare nuk janë zgjidhje. "Sot lufta me pandeminë ka armë të tjera në dispozicion: vaksinimi masiv i kombinuar me masa të distancës sociale. Ora policore dhe kufizimet në orare nuk janë zgjidhje. Rastet me fatalitet dhe të hospitalizuarit janë nga kategoritë që nuk po vaksinohen. Nuk mund të vazhdojmë të paguajmë dëmin që vjen si pasojë e joksistencës

të menaxhimit të pandemisë. Kufizime të rrepta duhet të zbatohen, por në këtë rast për ata që nuk po vaksinohen", ka shkruar Rukiqi. Edhe kryetari i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit, Hysen Sogojeva, ka thënë se pas hyrjes në fuqi të masave të reja, bizneset kanë nevojë për dorën e shtetit, derisa shton se përndryshe do të përkeqësohet situata. "Një studim që e kemi bërë vetëm në sektorin e dasmave që janë në fuqi masat aktuale diku 70 për qind janë mbajtur dhe 30 % nuk janë mbajtur për shkak të kufizimeve dhe 400 deri në 500 milionë euro humbje vetëm në sektorin e dasmave, mos të flasim tash se kjo do të bëhet vetëm në hapësirat e hapura dhe do të dëmtohet shumë. Apeloj që sa më shpejt ta kemi një takim me ministrin e Ekonomisë dhe t'u jepet ndihma bizneseve që kanë humbur, përndryshe do të keqësohet gjendja shumë dhe reagimet priten", ka thënë Sogojeva.

16 të vdekur dhe mbi 2 000 infektive të tjera me Covid

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit

janë raportuar 16 raste të vdekurve. Gjatë kësaj periudhe kohore janë infektuar me Covid edhe 2 098 qytetarë. "Prej 12 564 testeve, 2 098 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 16 raste të vdekurve. Sot janë shënuar 1 614 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 111 400. Në total numri i rasteve aktive është 25 407", është thënë në njoftimin për media të MSh-së. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 15 862 doza të vaksinës kundër Covid-19. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 15 862 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 780 637 doza të vaksinës. Deri më sot 261 818 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është thënë në njoftimin e ministrisë. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar se në spitalet e Kosovës 55 pacientë me koronavirus janë në gjendje të rëndë shëndetësore. Sipas raportit ditë, numri i përgjithshëm i pacientëve me koronavirus, të shtrirë në spitale, është 1 051. Prej këtyre, 952 pacientë janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi.

Dialogu Kosovë - Serbi vazhdon më 7 dhe 8 shtator

PRISHTINË, 27 GUSHT - Delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë pritet të takohen në Bruksel më 7 dhe 8 shtator në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të cilin po e lehtëson Bashkimi Evropian. Takimin e konfirmuan burimet diplomatike në Bruksel, duke

thënë se agjenda e bisedimeve nuk është caktuar ende. Takimi pritet të jetë në nivel të shefave të ekipeve negociuese. Delegacionin e Kosovës do ta kryesojë zëvendëskryeministri i parë Besnik Bislimi, ndërsa atë të Serbisë drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.

I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajčak, ka biseduar përmes telefonit me të dy kryenegociatorët për ta përgatitur takimin e tyre të radhës. “Pata diskutime përmbajtjesore, të ndara, me zëvendëskryeministrin e parë të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe me drejtorin e Zyrës së Serbisë për

Kosovën, Petar Petković, rreth përgatitjeve për takimin e radhës në nivel të kryenegociatorëve”, ka shkruar Lajčak në “Twitter”. Takimi i ekipit të Kosovës dhe atij të Serbisë pritet të shërbejë edhe për të përgatitur një takim në nivel të lartë midis kryeministrit të Kosovës, Albin

Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vučić. Edhe ky takim pritet të zhvillohet gjatë muajt shtator, por data për të nuk është caktuar ende. Takimi i fundit në nivel të lartë është zhvilluar më 19 korrik, por ai nuk ka prodhuar asnjë rezultat konkret.



Komandanti i KFOR-it vlerëson situatën e sigurisë në Kosovë



Prishtinë, 27 gusht (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, u takua me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici. Komandanti i KFOR-it e vlerësoi situatën e sigurisë në

vend të qetë dhe stabile, duke nënvizuar se institucionet përkatëse të sigurisë janë në bashkërendim të plotë me njëra-tjetrën. Komandanti i KFOR-it e informoi presidenten Osmani për stërvitjen “Stërvitje

dhe trajnim operacional - OPREH Niveli II”, e cila do të mbahet në shtator në Kosovë. Kjo është një stërvitje e rregullt rutinore. Stërvitja do ta përfshijë zbatimin e trupave shtesë të vendeve aleate të cilat

do të trajnohen bashkë me njësitet e KFOR-it si pjesë e Forcës Operacionale Rezervë të KFOR-it. Gjatë takimit presidentja Osmani diskutoi me komandantin e KFOR-it për

vendimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për të ofruar mbrojtje të përkohshme dhe të menjëhershme për kontraktuesit afganë që punojnë në NATO, përfshirë edhe familjet e tyre.

Situata me Covid, Ramosaj: Të gjithë mjekët e pensionuar të kthehen në punë

DEÇAN, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kapritur të premten në

takim drejtorin e Shëndetësisë, Musa Berisha, drejtorin e QKMF-së, Selmon Berisha, si

dhe një pjesë të mjekëve të cilët tashmë janë të pensionuar. Gjatë këtij takimi të përbashkët

janë pajtuar që të ftohen të gjithë mjekët e komunës së Deçanit të cilët janë në pension, që t'u

bashkohen ekipeve mjekësore për ta mundësuar menaxhimin e situatës me Covid-19.

Policia zbaton masat, kontrollon lokalet e kafeterive dhe organizimin e dasmave

FERIZAJ, 27 GUSHT (ER) - Në realizim të vendimit të qeverisë për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontroll, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, policia rajonale në Prizren ka ndërmarrë masa për kontroll duke zbatuar vendimin e qeverisë. "Gjatë inspektimit dhe kontrollimit në rrugën Prizren-Landovicë, në dy lokale të kafeterive, policia ka vërejtur se kanë punuar në kundërshtim me vendimin e qeverisë si dhe ka intervenuar në një aheng familjar (dasmë) të organizuar.

Për këtë janë informuar inspektorët të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të urdhrat të inspektorit, kafeteritë janë mbyllur, dasma është ndaluar dhe janë shpërndarë dasmorët. Në lidhje me këtë organizim në kundërshtim të vendimit të qeverisë janë shqiptuar dënime nga ana e inspektorëve", ka njoftuar Policia e Kosovës. Gjithashtu, për moszbatim të masave dhe ligjit për pandeminë, në tri ditët e fundit janë shqiptuar 400 tiketa trafiku për mosmbajtje të maskës,

distancës sociale dhe organizim të ahengjeve. "Andaj, në zbatim për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontroll, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, policia në Prizren do të vazhdojë të veprojë gjatë gjithë kohës së bashku me inspektorët dhe mekanizmat e tjerë shtetërorë në bazë të vendimit të qeverisë dhe Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Komuna e Mitrovicës pranon donacion mbi 10 mijë maska mbrojtëse nga FSK-ja



MITROVICË, 27 GUSHT (ER) - Komuna e Mitrovicës, respektivisht Drejtoria për Shëndetësi, ka pranuar donacion mbi 10 mijë maska mbrojtëse nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka falënderuar FSK-në për dhurimin e këtij donacioni shumë të nevojshëm në këtë kohë pandemie, duke thënë se këto maska mbrojtëse do të shërbejnë për nevojat e institucioneve dhe

të qytetarëve dhe ndihma të tilla janë të mirëseardhura për t'u mbrojtur nga virusi Covid-19. Edhe drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani, e ka vlerësuar shumë të dobishëm këtë donacion për kujdesin parësor shëndetësor, duke theksuar që Drejtoria e Shëndetësisë është e përkushtuar që së bashku me qytetarët të ruajë shëndetin publik. Vlen të potencohet se pjesëtarë të

Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë bërë shpërndarjen e maskave falas për kalimtarët e rastit në sheshin e qytetit në Mitrovicë, si dhe kanë ndihmuar edhe Qendrën e Vaksinimit me rreth 3 000 maska. Në fund ata u pajtuan se ky bashkëpunim i mirë në mes të komunës dhe FSK-së do të vazhdojë edhe në të ardhmen për të kontribuar për mirëqenien e mirë të qytetarëve.

Komuna e Podujevës dhe BSCK-Kosovo nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PODUJEVË, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar sot marrëveshje bashkëpunimi me Besnik Krasniqi, drejtor i Business Support Center Kosovo, për mbështetje të realizimit të projektit "Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjve dhe bizneseve aktive për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive për ndërmarrësi". Qëllimi i marrëveshjes dhe projektit në përgjithësi është zhvillimi i ndërmarrësisë në

Podujevë dhe përgatitja profesionale e të rinjve të diplomuar për punësim dhe vetëpunësim si dhe të kontribuojë për zhvillimin e ndërmarrjeve të reja. Kryetari Bulliqi ka thënë se përmes kësaj marrëveshjeje synojnë që me BSCK të realizojnë programe trajnimi kualitative dhe për të rinjtë, por edhe bizneset që dëshmojnë. "Do të ofrojmë grante për zhvillimin e ideve të reja për biznese përmes të cilave sigurohet zhvillim

ekonomik në komunën tonë", ka thënë ai. Vlera e përgjithshme e projektit është 48 691 euro, ndërsa për realizimin e tij komuna e Podujevës, përmes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik (DPZHE), do të ndajë 29 311 euro, ndërsa BSCK 19 380 euro. Në kuadër të marrëveshjes palët pajtohen për ofrimin në dispozicion të të gjitha resurseve, në favor të arritjes së niveleve më të larta të bashkëpunimit për realizimin e projektit.



Voting Result		
	Vote	Percent
Yes	23	45.10%
No	6	11.76%
Abstain	3	5.88%

Nuk kalon Plani Zhvillimor Komunal për Prishtinën

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Të premten ka dështuar miratimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) i Komunës së Prishtinës, i cili përcaktonte zhvillimin e kryeqytetit për tetë vjetët e ardhshëm. Me

këtë rast, kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës nga radhët e PDK-së, Uran Ismaili, i cili i pari ka bërë thirrje për mosvotim të këtij plani, ka thënë se pas aktivizimit qytetar dhe pas angazhimit,

insistimit e thirrjeve të tyre publike për ndalimin e këtij plani, që u mundua të kalojë pa diskutime të gjera e të mirorganizuar publike, pa pjesëmarrje, pa transparencë, PZHK-ja është ndaluar. "U

dëshmuar edhe një herë se kur bëhemi bashkë për të mirën e qytetit, asnjë plan e praktikë e dëmshme për Prishtinën nuk mund të kalojë", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Krasniqi me ambasadorin turk: Turqia, krah i fuqishëm i Kosovës

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur sot në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, me të cilin kanë diskutuar për bashkëpunimin me interes të përbashkët, në veçanti për zhvillimin e

fuqizimin e shtetit të Kosovës. “Në historinë tonë të re, Turqia me dashamirësi ka marrë pjesë në shtetndërtim, duke u bërë krah i fuqishëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë institucionale, në veçanti duke kontribuar në zhvillimin ekonomik. Në çdo rrethanë

Turqia ka dëshmuar miqësinë e sinqertë, me kontribut të madh për integrimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe njohjen e shtetësisë së Kosovës nga shtetet e treta. Urat e forta të mirëbesimit mund të fuqizohen edhe më shumë”, ka thënë Krasniqi pas takimit.



Konceptdokumenti i vetingut, drejt finalizimit

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Në Ministrinë e Drejtësisë të premtën është mbajtur një takim i përbashkët në mes të përfaqësuesve të kësaj ministrie dhe ekspertëve ndërkombëtarë lidhur me procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë.

Pjesë e takimit përmes platformës online ishte edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Fokus i diskutimit në takim ishte analiza e ekspertëve ndërkombëtarë mbi konceptdokumentin për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë.

Mbështetur nga Ambasada e Britanisë në Kosovë, ekspertët ndërkombëtarë, Ken Taylor dhe David Wells, shpalosen ekspertizën e tyre për

konceptdokumentin, bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Fokus i veçantë i diskutimit ishin: kriteret profesionale dhe të integritetit lidhur me vetimin e gjykatësve dhe prokurorëve, vetimi i tyre në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe të privatësisë, nivelet e vetimit sipas hierarkisë dhe kohëzgjatja e vetimit.

Gjithashtu, janë diskutuar mekanizmat ligjorë me kompetencë për zhvillimin e vetingut si dhe opsionet e përshtatshme të cilat do të garantonin një proces të vetingut bazuar në kriteret profesionale, sipas standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kanë theksuar se kjo



ministri do të ndjekë këtë bashkëpunim me prioritet të veçantë me qëllim të finalizimit

të këtij procesi i cili vlerësohet të jetë nga më të rëndësishmit për ta çuar përpara reformën

në drejtësi për të garantuar mirëfunksionimin e institucioneve të drejtësisë.

KQZ-ja nuk e certifikon kandidaturën e Selim Pacollit për kryetar të Prishtinës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Selim Pacolli ka njoftuar të premtën se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk e ka certifikuar kandidaturën e tij për kryetar të komunës së Prishtinës. “Sapo mora lajmin se KQZ-ja nuk do ta certifikojë kandidaturën time për kryetar të Prishtinës si pasojë e një aktvendimi të vitit 2019, që unë kam bërë deklarin e pasurisë 48 orë pas përfundimit të afatit ligjor për deklarin, (përfshirë ditët e vikendit). Me saktë, afati ishte të premtën, ndërsa deklarimi të hënën, në orën 8:00 të mëngjesit, në praninë time fizike. Kjo vonesë ka ndodhur si pasojë e udhëtimit tim për çështje shëndetësore jashtë



vendit. Edhe pse në esencë ky është një vendim arbitrar dhe i

palogjikshëm, vendimet e gjyqësorit janë të shenjta dhe të

padiskutueshme”, ka thënë Pacolli.

Ai ka thënë se edhe pse nuk do të jetë zyrtarisht kandidat për kryetar të Prishtinës, dëshira dhe angazhimi i tij për qytetarët e Prishtinës është edhe më i madh. “Unë do t’u qëndroj besnik dhe do t’i mbështes në çdo hap të gjithë kandidatët e listës sonë për kuvendin komunal, në veçanti kandidatin e subjektit tim AKR-së për kryetar të Prishtinës”, ka thënë ai.

Pacolli ka thënë se do ta vazhdojë angazhimin e tij për kryeqytetin. “Do të vazhdoj implementimin e të gjitha projekteve të planifikuara për këtë mandat, dhe projektet e parapara për mandatin vijues, e që janë jetike për qytetin tonë”, është shprehur Selim Pacolli, i cili aktualisht mban postin e nënkryetarit të komunës së Prishtinës.

Shpërndahen materiale mbrojtëse kundër Covidit për mediat lokale

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka shpërndarë të premtën materiale mbrojtëse kundër Covid-19 për mediat lokale nga pjesa e fundit

të donacioneve të siguruar më parë. Për mediat lokale nga Prizreni, Ferizaj, Klina, Istogu, Peja, Mitrovica Veriore, Kamenica janë shpërndarë xhaketa, jelekë, maska, dorëza,

veshje mbrojtëse, mburoja fytyre, dezinfektues 100 dhe 1000 ml. AGK-ja ka falënderuar sërish të gjithë bashkëpunëtorët vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë

mbështetur komunitetin që përfaqëson duke u siguruar materiale mbrojtëse në mënyrë që t’u lehtësohet puna që bëjnë në kushtet me ballafaqimin me pandeminë Covid-19.



Dogana e Kosovës parandalon 17 tentim mashtrime përmes faturave të manipuluar

PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Sektorët e specializuar të Doganës së Kosovës, në sajë të një operacioni të organizuar për t'i luftuar mashtrimet doganore dhe kontrabandën, vetëm gjatë datës 26 gusht kanë arritur të zbulojnë 17 raste të mashtrimit, kryesisht të importit të veturave. Në njoftimin për media të Doganës theksohet se mashtrimet e dyshuara janë bërë me qëllim që të zbatohen vlera më të ulëta të pagesës së detyrimeve. "Vlen të ceket se si rrjedhje e këtij plani janë shqiptuar 10 kundërvajtje doganore dhe janë iniciuar për hetim penal dy raste që kanë pasur shmangie më të larta. Rastet e tjera janë duke u administruar derisa të përfundohen procedurat e nevojshme të verifikimit", thuhet në njoftimin për media. Dogana e Kosovës ka theksuar se

është në dijeni për tentim mashtrimet në këtë fushë dhe kërkon nga subjektet tregtare dhe qytetarët që të bashkëpunojnë dhe të përmbahen nga mashtrimet në cilëndo formë të mundshme. "Dogana e Kosovës synon që në bashkëpunim me qytetarët ta mbrojë interesin e shtetit, duke u pamundësuar kriminelëve që të përfitojnë nga taksat e qytetarëve. Andaj, mirëpresim bashkëpunimin me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mënyra më e sigurt është që të na kontaktoni përmes telefonit 0800 500 95, Facebook Dogana e Kosovës ose e-mail: info@dogana-ks.org. Me bashkëpunim efikas secili bëhet pjesë e luftës ndaj krimit. Duke mbrojtur të hyrat ne i krijojmë më shumë mundësi zhvillimit të vendit", thuhet në njoftimin e Doganës.



37 për qind e rrugëve nuk kanë kontrata për sinjalistikë



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Rreth 40 për qind e rrugëve në Kosovë nuk janë të mbuluara me kontratë për sinjalistikë. Vetëm në dy javët e fundit janë shpërndarë dhjetë gjoba për kompanitë që punojnë për ndërtim të rrugëve. Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë mbajtur të premtën konferencë për sigurinë në trafikun dhe infrastrukturën rrugore. Të dyja këto institucione u kanë bërë thirrje të gjitha kompanive që

punojnë në ndërtim të rrugëve që të kenë kujdes edhe t'i respektojnë kushtet e kontratës.

Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi nga Pestova, ka thënë se shumë vendpunishte kanë mbetur të pasiguruara dhe të njëjtave u mungon sinjalistika e duhur. "Ne sot jemi këtu bashkë me Policinë e Kosovës që të paraqitemi para publikimit për një projekt të përbashkët, ku e kemi rritur intensitetin e inspektimeve në të gjitha punishtet që ndodhen në rrugët e Kosovës sa i përket sigurisë rrugore. Siç e dini, kur ne kemi ardhur në qeverisje kemi gjetur një numër shumë

të madh të projekteve të cilat kanë qenë të bllokuara dhe me vite të tëra nuk janë zhvilluar punimet aty. Kanë mbetur vendpunishtet në shumë vende të pasiguruara dhe në shumë vende pa sinjalistikën e duhur sa i përket aspektit të sigurisë rrugore. Diku 37 për qind të rrugëve nuk janë të mbuluara me kontrata për sinjalistikë për shkak se nuk ka pasur kontrata prej vitit 2017 deri më tani. Tani ne kemi shpallur tenderin për sinjalistikë dhe është në procedurë. Besoj se shumë shpejt do të përfundojnë procedurat e prokurimit në mënyrë që t'i nënshkruajmë këto kontrata", ka bërë me dije zëvendësministri Durmishi.

Afaristi Shkëlqim Devolli takon presidentin turk Erdogan, bisedojnë për ekonominë

SARAJEVË, 27 GUSHT (ER) - Afaristi nga Kosova, Shkëlqim Devolli, është takuar të premtën në Sarajevë me presidentin e Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Temë e bisedës së tyre ka qenë zhvillimi ekonomik i rajonit, si dhe

marrëdhëniet tregtare në mes të shtetit turk dhe Kosovës. Presidenti Erdogan i ka shprehur Devollit admirimin për Kosovën, duke potencuar marrëdhëniet speciale ndërmjet të dy popujve. Afaristi Devolli, në anën tjetër, e ka falënderuar

presidentin turk për ndihmën e vazhdueshme dhënë Kosovës dhe popullit të saj, duke nënvizuar se ka hapësirë për shtim edhe më të madh të bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimit tregtar ndërmjet rajonit dhe Turqisë.





SI BINDEN TË BËHEN SPIUNË NJERËZIT E ZAKONSHËM

Nga Chris SMITH

Një film i ri "The Courier" (Korrieri), me protagonist aktorin Benedikt Kamberbaç, rrëfen historinë e shitësit, Grenvi Uajn, të mbërthyer në botën e turbullt të spiunazhit gjatë Krizës së Raketave Kubane. Filmi po shfaqet në kinema fill pas lajmit që bujshëm mbi Dejvid Smith, 57 vjeçarin me një pamje mëse normale, i punësuar si roje sigurisë në ambasadën britanike në Berlin, dhe që rezultoi të ishte rekrutuar si spiun nga shërbimi sekret rus. Po pse bëhen spiunë njerëzit në dukje më se të zakonshëm? Në vitin 1988, dezertori i KGB-së, Stanislav Levçenko, përmendi termin amerikan, MICE, që nënkupton "paratë", "ideologjinë", "shtrëngimin/kompromisin" dhe "egon". Ai tha se ndjeshmëria ndaj këtyre faktorëve, ishte dobësia kryesore e një objekti, e që mund të shfrytëzohej nga shërbimet e ndryshme sekrete.

Paratë

Zyrtarët e zhytur në borxhe, janë objektivat më të preferuara për rekrutuesit. Për shembull në vitin 1935, Xhon Herbert King, një nëpunës shifruer për

Zyrën e Jashtme Britanike, kishte një problem. Ai ishte dëbuar nga shtëpia nga gruaja e tij, bënte një jetë shumë të kushtueshme, kishte një djalë dhe një të dashur për të mbajtur me para, dhe ndërkohë merrte një pagë të vogël.

Në këto kushte, ai u pa si një objektiv ideal për rekrutim nga shërbimi sekret sovjetik. Atij iu afrua Henri Pik, një spiun sovjetik, që pretendonte të ishte një biznesmen dhe pjesëtar i shtresës së lartë britanike. Pik e bindi nëpunësin që të ndryshonte gjendjen e familjes së tij.

King pranoi t'i shiste sekretet e Zyrës së Jashtme, të cilat besohej se do të përdoreshin për t'i siguruar Pik dhe një banke holandeze një avantazh të tregut të aksioneve. King iu premtoi një pjesë e këtyre fitimeve, e cila arrinte në 100 paund në muaj. Por veprimtaria e tij përfundoi në vitin 1937, kur eprori i tij u thirr në Moskë gjatë spastrimeve të Stalinit. King u arrestua në vitin 1939, dhe u dënua me 10 vjet burg.

Ideologjia

Disa njerëz janë të gatshëm të rrezikojnë jetën për bindjen e tyre politike. Një individ i tillë ishte Donald Maklin, që u diplomua në Universitetin e Kembrixhit. Ai kishte

pikëpamje të majta, të cilat u shndërruan në një besim ideologjik të verbër ndaj drejtësisë së kauzës komuniste sovjetike.

Në vitin e tij të fundit në universitet, 1934, ai u rekrutua nga NKVD (një agjenci e policisë sekrete sovjetike, paraardhëse e KGB-së). Maklin u udhëzua të heqë dorë nga aktivizmi i tij politik, dhe të bëhej pjesë e establishmentit britanik. Shumë shpejt ai iu bashkua Zyrës së Jashtme, ku u angazhua si një nga spiunët më të dëmshëm të brezit të tij.

Por Maklin nuk ishte i vetmi. Ai ishte anëtar i Pesëshes të Kembrixhit, ku bënin pjesë Kim Filbi, Gai Barxhes, Antoni Blënt dhe Xhon Kairnkros. Secili prej tyre u rekrutua nga shërbimi sekret sovjetik gjatë ose menjëherë pas përfundimit të studimeve në Kembrixh.

Si rezultat i edukimit të tyre solid, secili prej tyre ishte në gjendje të depërtonte në zonat më të ndjeshme të shtetit britanik, në Zyrën e Jashtme, Zyrën e Kabinetit, MI5, MI6. Pas demaskimit të tyre në vitin 1951, Maklin dhe Barxhes u arratisën në Moskë.

Shtrëngimi ose kompromisi

Në vitin 1946, Xhon Vasal nisi punë si asistent i atasheut të

Marinës në ambasadën britanike në Moskë. Sidoqoftë, ai ruante një sekret. Vasal ishte një homoseksual në një kohë kur homoseksualiteti në Britani ishte i paligjshëm. Të dënuarit për homoseksualitet, përballeshin me dënime me burg.

KGB e zbuloi sekretin e Vasal, dhe arriti të realizojë disa fotografi komprometuese, për t'i përdorur si shantazh kundër. Në këto kushte në vitin 1956 Vasal u transferua sërish në Londër, në radhët e shërbimit sekret të marinës britanike.

Nga atje ai mund të siguronte një rrjedhë të qëndrueshme informacionesh sekrete, përfshirë sekretet teknike në lidhje me radarët dhe armët. Kjo punë, për të cilin Vasal u shpërblye mirë, zgjati deri në vitin 1962 kur ai u arrestua pas dezertimit të oficerit të KGB-së, Anatoli Golitsin. Në vitin 1962, pas një skandali të madh që e tronditi qeverinë e Harold Makmilan, Vasal u dënua me 18 vjet burg, dhe u lirua në vitin 1972.

Të motivuar nga egoja personale

Për disa, spiunazhi është një mundësi për të manipuluar fshehurazi njerëzit përreth tyre, dhe për të dëshmuar kështoj superioritetin e tyre.

Një agjent i FBI-së, që ishte njëherazi spiun për llogari të sovjetikëve në vitet 1976-2001, Robert Hansen hyn pikërisht në këtë kategori.

Hansen kishte në dukje një jetë të zakonshme. Në fakt ai bënte një jetë të dyfishtë si spiun, duke pasur edhe një lidhje sekrete me një balerinë, të cilin e mbushte me dhurata të shtrenjta. Paraja ishte motivi fillestar për Hansen. Ai mori 1.43 milion dollarë në para dhe diamante nga eprorët e tij sovjetikë. Gjithsesi, Hansen ishte një njeri që e kërkonte vëmendjen me çdo kusht.

Ai u ndje i pavlerësuar nga drejtuesit e FBI-së, që sipas vlerësimit të tij, nuk arritën të njohin si duhet aftësitë e tij. Karriera e tij 2-dekadëshe si një agjent i dyfishtë, që përfshiu zbulimin e identiteteve të të paktën 9 spiunëve amerikane në Bashkimin Sovjetik, ishte një mundësi për të treguar superioritetin e tij ndaj kolegëve të tjerë në FBI.

Hansen po vuan aktualisht 15 dënime të njëpasnjëshme me burgim të përjetshëm, dhe spiunazhi i tij është përshkruar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë si "ndoshta katastrofa më e rëndë e shërbimit sekret në historinë e SHBA-së". / "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina dhe Ballkani kërkojnë maksimumin në derbi

Skuadra e Prishtinës dhe ajo e Ballkanit të dielën ndajnë mejdanin në stadiumin "Fadil Vokrri". Këto klube luajtën baras në javën e parë ndaj Malishevës, përkatësisht Dukagjinit. Tash synojnë ta regjistrojnë fitoren e parë. "Duhet ta harrojmë ndeshjen e parë dhe të fokusohemi në ndeshjen e dytë. Jemi mjaft të motivuar për të dielën. Na pret një skuadër e fortë siç është Ballkani. Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje dhe, nëse luajmë siç dimë ne, do ta arrijmë edhe fitoren", ka thënë Besnik Krasniqi, futbollist i Prishtinës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kampionia në fuqi, Prishtina dhe Ballkani të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" do të përballen në kuadër të derbit të javës së dytë në Superligën e Kosovës në futboll. Të dyja këto skuadra duan fitoren e parë në këtë kampionat, pasi në xhiron e parë që të dyja luajtën baras. Prishtina vetëm në çastet e fundit të ndeshjes e barazoi rezultatin kundër Malishevës (1-1), ndërsa Ballkani luajti 2-2 me Dukagjinin e Klinës. Mbrojtësi i Prishtinës për "Epokën e re" ka thënë se të

dielën skuadra "bardhekaltrë" në këtë ndeshje do ta shijojë fitoren. "Duhet ta harrojmë ndeshjen e parë dhe të fokusohemi në ndeshjen e dytë. Jemi mjaft të motivuar për të dielën. Na pret një skuadër e fortë siç është Ballkani. Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje dhe, nëse luajmë siç dimë ne, do ta arrijmë edhe fitoren", ka thënë Krasniqi. Për ndeshjen ndaj kryeqytetasve ka folur edhe trajneri Bekim Isufi. Ky ka premtuar maksimumin për rezultat pozitiv. "Kemi bërë një ndeshje të mirë, por gabime ka në futboll dhe ne do të përpiqemi t'i përmirësojmë ato në çdo seancë

stërvitore. Jemi të kompletuar. Kemi një kundërshtar kampion. Ne do të dalim në fushë ta japim maksimumin për t'ia arritur qëllimit", ka thënë Isufi.



Nuhiu: Presim ndeshje të vështirë ndaj Llapit

Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, ka folur për ndeshjen e radhës që skuadra e tij e zhvillon kundër Llapit. "E kemi një përballje shumë të vështirë ndaj një kundërshtari siç është Llapi, i cili ka ruajtur grupin dhe ka sjellë

lojtarë shumë cilësorë. Kemi analizuar detajet më të vogla për t'i mbyllur pikat e tij të forta dhe normalisht do të përpiqemi t'i shfrytëzojmë hapësirat që do t'i lë kundërshtari", ka deklaruar Nuhiu.

SUPERLIGA - Java e dytë

Të shtunën takohen:
17:00 Drita - Llapi
17:00 Ulpiana - Malisheva

Të dielën takohen:
17:00 Prishtina - Ballkani
17:00 Feronikeli - Gjilani

Të hënën takohen:
17:00 Dukagjini - Drenica

Cana: 'Arena Kombëtare' është imazh krenarie për gjithë Ballkanin

TIRANË, 27 GUSHT - Lorik Cana është ambasador i UEFA-s për finalen e madhe të Ligës së Konferencës. Gara e tretë më e madhe evropiane për klube do të nisë për herë të parë këtë edicion 2021/22, ku finalja e madhe do të luhet në stadiumin 'Arena Kombëtare' në Tiranë. Ish-kapiteni legjendar i Shqipërisë, Lorik Cana, ka hedhur shortin në Ligën e Konferencës, ku tanimë 32 skuadrat

pjesëmarrëse kanë mësuar kundërshtarët e tyre. Para hedhjes së shortit, Cana ka folur për karrierën e tij, duke thënë se është krenar që ka arritur të bëjë karrierë të tillë. Fillimisht prezantuesi ka thënë se është kënaqësi që ta ketë aty, duke e pyetur rreth karrierës së tij pasi ka luajtur në shtete si Franca, Anglia, Italia e Turqia. "Nëse kthehesh dhe shikon mbrapa, shumë prej fëmijëve që luajnë futboll duan të



arrijnë nivelin më të lartë. Jam shumë krenar për atë që kam arritur në karrierën time. Të luash me PSG-në, pastaj me skuadrën

që kam bërë gjithmonë tifo që nga fëmijëria, Olympique Marseillen, Galatasarayn e Lazion, është një arritje e madhe jo si futbollist, por edhe si person. Udhëtimi im si futbollist është krenaria ime më e madhe", ka thënë Cana. Cana është pyetur edhe për stadiumin "Arena Kombëtare" në Tiranë, ku do të luhet finalja e madhe e Ligës së Konferencës. "Stadiumi 'Arena Kombëtare' është të themi një imazh krenarie

për Ballkanin si imazh i shtetit dhe qytetit. Stadiumi është mjaft i mirë dhe i ri, shumë modern dhe një nga stadiumet më të reja në Evropë", ka shtuar Cana. "Arena Kombëtare" është shumë modern dhe shumë aktiv, ndodhet në mes të qytetit. Jam i sigurt që do të jemi priturë të shkëlqyer dhe njerëzit do të udhëtojnë për ta parë ndeshjen finale në mes të qytetit dhe do të shijojnë vendin tonë të bukur, Shqipërinë", ka deklaruar Cana.

32 skuadrat mësojnë kundërshtarët në Ligën e Evropës

STAMBOLL, 27 GUSHT - Ky sezon i Ligës së Evropës vjen me një format ndryshe pasi nga 48 skuadra dhe 12 grupe që ishin më parë, do të jenë vetëm 8 grupe dhe 32 skuadra me 8 të parat që do të kualifikohen në fazën e 1/8-ave, ndërkohë që 8 skuadrat e renditura në vendet e dyta do të përballen me tetë skuadrat që vijnë nga Liga e Kampionëve për të përcaktuar 16 ekipet që do të marrin pjesë në raundin e 1/8-ave. Goglat e përzgjedhura nga dy ish-lojtarë spanjollë si Marcos Senna dhe Andres Palop vendosën në grupin A Olympique Lyon, Rangers, Spartën e Pragës dhe Brondbyin me skuadrën e Peter Bosz që edhe falë cilësive të Xherdan Shaqirit, konsiderohet

favoritja kryesore në këtë grup. Grupi B është edhe një nga më interesantët e këtij kompeticioni pasi do t'i matin forcat Monaco, PSV Eindhoven, Real Sociedad dhe Sturm Graz. Short i pranueshëm edhe për Napolin që, pavarësisht se është në grup me anglezët e Leicester Cityt, do të ketë si kundërshtarë edhe Spartakun e Moskës dhe Legjan e Varshavës, skuadër ku luajnë edhe dy ish-futbollistët e Tiranës, Muçi dhe Çelhaka. Grup shumë i balancuar mund të konsiderohet ai D me ekipe si Olympiacos, Eintracht Frankfurt, Fenerbahçe dhe belgët e Antwerpit të cilët është transferuar së fundmi ish-mesfushori i Romës dhe Interit Radja Nainggolan. Grup me emra të



mëdhenj mund të konsiderohet grupi E ku, përveç Lazios së Sarrit, Hysajt, Strakoshës dhe Muriqit, bëjnë pjesë edhe Lokomotiva e Moskës, Olympique Marseille i Jorge Sampaolit dhe gjigantët turq të Galatasarayt. Grup pa emra të mëdhenj ai F me ekipe si Braga, Crvena Zvezda,

GRUPET E LIGËS SË EVROPËS

Grupi A: Lyon, Rangers, Sparta Praga, Brondby
Grupi B: Monaco, PSV, Real Sociedad, Sturm
Grupi C: Napoli, Leicester City, Spartak Moskë, Legia Varshava
Grupi D: Olympiacos, Frankfurt, Fenerbahçe, Antwerp
Grupi E: Lazio, Lokomotiva Moskë, Marseille, Galatasaray
Grupi F: Braga, Crvena Zvezda, Ludogorets, Midtjylland
Grupi G: Leverkusen, Celtic, Real Betis, Ferencvaros
Grupi H: Dinamo Zagreb, Genk, West Ham United, Rapid Viena

Ludogorets dhe Midtjylland, raporton "Supersport". Short shumë i vështirë për Ferencvarosin e Myrto Uzunit që do t'i matë forcat në grupin G me gjermanët e Bayer Leverkusenin, skocezët e Celticit dhe spanjollët e Real Betisit. Në grupin H dhe atë të fundit skuadra më e kuotuar për t'u renditur në vendin e

parë është West Ham, edhe pse anglezët e kanë pjesëmarrjen e tyre të parë në fazën e grupeve të Ligës së Evropës, ndërsa bashkë me Hammers bëjnë pjesë edhe Dinamo Zagreb, Genk dhe Rapid i Vjenës. Ndeshjet e para të fazës së grupeve të këtij edicioni të Ligës së Evropës do të zhvillohen më 16 shtator.

Zvicra publikon listën, ftohen tre futbollistë shqiptarë

Cyrih, 27 gusht - Përfaqësuesja e Zvicrës në futboll nis një cikël të ri, me trajner të ri pas largimit të Vladimir Petkoviçit. Helvetikët do t'i zhvillojnë tri ndeshje kualifikuese për Kupën e Botës në muajin shtator dhe trajneri i ri Murat Yakin ka publikuar listën e futbollistëve. Zvicra do

të përballet me Greqinë më 1 shtator, me Italinë më 5 shtator si dhe me Irlandën më 8 shtator në udhëtim. Nga lista e publikuar nga Yakin, në të janë edhe tre futbollistë shqiptarë të ftuar. Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka dhe Andi Zeqiri janë grumbulluar nga Yakin për këto tri

ndeshje. Lista e plotë: Kobel, Mvogo, Sommer, Akanji, Benito, Comert, Elvedi, Lotomba, Mbabu, Rodriguez, Schar, Widmer, Zesiger, Aebischer, Embolo, Fasnacht, Freuler, Gavranović, Seferović, Shaqiri, Sow, Steffen, Vargas, Xhaka, Zakaria, Zeqiri, Zauber.



Ronaldo largohet nga Juventus, Unitedi kërkon rikthimin e CR7 në 'Old Trafford'



MANCHESTER, 27 GUSHT - E ardhmja e Cristiano Ronaldos vazhdon të jetë një mister, por krejt çfarë dihet është se është larguar nga Juventus. Portugezi tanimë ka marrë rrugën për në qytetin e lindjes, Lisbonë, ku do të presë disa ditë para se të vendos për klubin e ri. 36-vjeçari flitet se do të rikthehet në elitën e futbollit anglez, Ligën Premiere. Manchester City është skuadra favorite për të nënshkruar me portugezin por, së fundmi, në garë është futur edhe Manchester Unitedi. Ka qenë mediumi anglez "TalkSport" që ka raportuar se "Djajtë e Kuq" janë futur fuqishëm në garë për transferimin e portugezit. Gjithnjë sipas këtij mediumi, skuadra nga "Old Trafford" beson se do t'i mposhtë rivalët nga

qyteti për t'i siguruar shërbimet e portugezit. Edhe vetë trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjær, ka folur për të ardhmen e Ronaldos. "Nuk e mendoja se Cristiano do të largohej nga Juventus. Ka pasur spekulime ditët e fundit dhe këtë mëngjes, por nuk e mendoja. Ne gjithmonë kemi pasur një komunikim të mirë me të. E di që Bruno Fernandes ka folur me të. Ai e di se çfarë ndiejmë për të dhe nëse ai do të largohej ndonjëherë nga Juventus, e di që ne jemi këtu", ka thënë Solskjær.

Allegri: Ronaldo të enjten më tha se do të largohet

Trajneri i Juventusit, Max Allegri, ka konfirmuar se Cristiano

Ronaldo nuk do të luajë me në Juventus, edhe pse para ndeshjes kundër Udineses trajneri italian thoshte të kundërtën. Tekniku i bardhezinjve foli para mediave në prag të duelit që Juventus luan ndaj Empolit. "Të enjten zyrtarisht Ronaldo më tha se nuk ka ndërmend të luajë për Juventusin. Për këtë arsye ai nuk do të grumbullohet për ndeshjen e radhës. Nga Juve kanë kaluar Sivori, Platini, Del Piero, Zidane, Buffon, të gjithë kampionë të mëdhenj. Ligji i jetës është ky: Juventus mbetet dhe kjo është gjëja më e rëndësishme dhe baza për marrjen e rezultateve. Kanë kaluar tre vjet, ai dha kontributin e tij dhe tani largohet. Jeta vazhdon, siç është normale", ka thënë Allegri.

SHKURT

Khaka edhe një herë refuzon ftesën e Shqipërisë

Taulant Xhaka ka refuzuar t'i bashkohet kombëtares së Shqipërisë, duke iu përgjigjur negativisht ftesës së trajnerit Edi Reja. Nuk është rasti i parë i refuzimeve të mesfushorit të Baselit i cili mungon në kombëtare së Shqipërisë që nga 9 tetori i vitit 2019. Nuk janë të qarta arsyet zyrtare të refuzimit, por emri i Xhakës nuk është më në listën e trajnerit Edi Reja për tri ndeshjet zyrtare eliminatorë për fazën e grupeve të Botërorit "Katar 2022" ndaj Polonisë, Hungarisë dhe San Marinos.

Moreno shpallet lojtari më i mirë i sezonit në Ligën e Evropës

Gerard Moreno është shpërblyer nga UEFA. Moreno është shpallur futbollisti më i mirë i edicionit 2020/21 në Ligën e Evropës. Një çmim shumë i merituar ky për sulmuesin që shkëlqeu sezonin e kaluar me Villarrealin duke fituar trofeun në fund. 29-vjeçari realizoi shtatë gola dhe katër asistime në 12 ndeshje të zhvilluara në Evropa Ligë. Në ndërkohë së shpejti do të hidhet shorti për edicionin e ri të këtij kompeticioni.

'Marca': Mbappe do t'i bashkohet Realit

Kylian Mbappe drejt Real Madridit. "Marca" raporton se palët janë shumë pranë nënshkrimit dhe PSG-ja është dorëzuar pas ofertës së fundit. Spanjollët kanë ofruar 170 milionë euro, plus 10 milionë të tjera në formë bonusesh, për të afruar në skuadër kampionin e botës. PSG-ja nuk mund ta humbasë Mbappen me parametra zero. Vetë lojtari ka qenë i qartë dhe ka shprehur vullnetin për t'u larguar dhe për të nënshkruar me Realin. Sipas gazetës spanjolle, gjatë orëve në vijim pritet zyrtarizimi i marrëveshjes mes klubeve.

Casemiro rinovon kontratën me Realin

Real Madridi ka arritur marrëveshje me mesfushorin Casemiro për zgjatjen e kontratës. Futbollisti brazilian me kontratën e re do të mbetet te 'Mbretërit' deri në qershor të vitit 2025. Gjiganti spanjoll fillimisht vazhdoi kontratën me Karim Benzeman, më pas me Federick Valverden, kurse tash me Casemiron. Braziliiani ka pasur paraqitje tejet të mira sezonet e fundit me "Los Blancos", duke krijuar një mesfushë të frikshme me Toni Kroosin dhe Luka Modriçin.

Leclerc: SPA pistë e vështirë, por do të jemi skuadra surprizë

Pista belge e SPA ku ditën e diel do të zhvillohet gara e radhës së botërorit të Formula 1 konsiderohet e vështirë për Ferrarin. Gjithsesi, Charles Leclerc mendon se mund të befasojë këtu dhe e konsideron "kokëkuqen" si makinën surprizë. "Kjo është një pistë e vështirë për ne, por këtë vit kemi pasur disa fundjava ku kemi befasuar dhe bërë paraqitje të mirë atëherë kur nuk pritej. Shpresoj që kjo fundjavë të jetë sërish e tillë dhe të befasojmë me paraqitjen tonë", ka thënë Leclerc. "Kjo është një pistë e gjatë, që pilotët e pëlqejnë shumë. Sidomos i jashtëzakonshëm është sektori i parë, që mund të dhurojë surpriza në kthesat e para. Ndaj, nëse do të na jepet mundësia, do ta shfrytëzojmë atë për të fituar", ka shtuar Leclerc.


Rossi: Ja përse nuk u tërhoqa kur isha ende kampion

ROMË, 27 GUSHT - Piloti italian Valentino Rossi, legjenda e motoçiklizmit dhe MotoGP, do të lërë sportin në fund të këtij sezoni. Prej disa vjetësh rendimenti i tij në pistë ka lënë për të dëshiruar. "Ndihem mirë, por ky ishte vendimi i duhur. Unë mund të garoj edhe për 20 vjet të tjera, por nuk mund të vazhdoj më në këtë mënyrë",

ka thënë Rossi. "Vendosa të tërhoqem pasi rezultatet nuk janë ato që prisja. Nëse nuk fiton, nuk argëtohem. Kjo vlen për të gjithë. Për fat të keq, gjatë vitit të fundit për shumë arsye nuk jam më i fortë si dikur, nuk jam i shpejtë për të dueluar për podiumin dhe fitoren", u shpreh Rossi. "Niveli i pilotëve po rritet dhe kur je i vjetër në moshë, duhet të

stërvitesh më shumë. Sot argëtohem më pak se dikur, edhe pse deri në fund u përpoqa të rezistoj. Nuk doja të ndalesha kur isha në kulmin tim, kampion bote, pasi doja të fitoja sërish dhe nuk doja të kisha pengje. Ndaj, sot jam i lumtur dhe i qetë, pasi e di që kam qenë në majë për shumë kohë", ka deklaruar Rossi.





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Renta Ajan” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811441550 me pronar Dafina Rashica, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Renta Ajan” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811441550 Dafina Rashica ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Renta Ajan” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811441550 Dafina Rashica the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Gonita Limoni shpall të pavlefshme Licencën e Punës me numer Ko-07339-01, Nr. 4575/1654-2020 të lëshuar nga Oda e Mjekëve të Republikës së Kosovës.
- ▶ Nexhet Morina shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- ▶ Rabije Kurteshi Ferati shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Migjeni” nga klasa 9 -6
- ▶ Bleta Komoni shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- ▶ Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “ Migjeni”
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 9-te te gjmnazit “ Frang Bardhi”
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Valentina Kurti shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomen e gjmnazit “Frang Bardhi”
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen “Mati 1” Rr. “Muharrem Fejza”, banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Daut Gashi shpalle te pavlefshme diplomen e SHMLT “Arkitekt Sinani” (Ish Boris Kidric)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen “Mati 1” rruga “Muharrem Fejza” Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Diellza Dibrani shpalle te pavlefshme dëftesën e SHMU “Azem Bejta”
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen “Mati 1” përball “Super Vivës”, me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Gentrit Krasniqi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Abdullah Shabani”
- ▶ Medi Construction “Sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 71344886
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ D.p.t “Suela” shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70725703.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

